




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



SHKOLLA E MËSIME PROFESIONALE  
"FERIZ GURI DHE VËLLEZËRIT ÇAKA"  
KAÇANIK



|          |            |          |         |         |
|----------|------------|----------|---------|---------|
| I        | Data       | 17.09.19 | Vendi   | KAÇANIK |
| Nj. org. | Numri      |          | Shtojcë |         |
| 04       | 0101-30540 |          | /       |         |

SH.M.P "F.Guri dhe V.Çaka" Kaçanik

Nr. 3929, 16.9.2019

## KËRKESË OFERTIMI PËR EKSURSION NË SHQIPËRI

Bazuar në Ligjin Nr.04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 20 dhe neni 23, në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2016 të 12.01.2016 të MASHT për Aktivitetet Jashtëshkollore, në vendimin e Këshillit Drejtues të Shkollës; me pëlqimin e Këshillit të Nxënësve e të prindërve, si dhe me pëlqimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës për organizimin e Ekskursionit të Maturantëve në Shqipëri, Drejtoria e SH.M.P "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" në Kaçanik, shpall:

### KËRKESË OFERTIMI PËR EKSURSION TË MATURANTËVE NË SHQIPËRI

Numri i paraleleve-nxënësve: 11 paralele -- 184 nxënës.

Koha e ekskursionit: nga 25.09.2019 deri më 29.09.2019 (5 ditë e 4 netë).

Vendi: Shqipëri.

Itinerari:

- Kaçanik-Krujë-Durrës (vendqëndrimi kryesor);
- Durrës-Vlorë;
- Durrës-qyteti i vjetër;
- Durrës-Tiranë;
- Durrës-Lezhë-Kaçanik.

Kompanitë-agjencionet ofertuese duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Licencën;
- Kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore;
- Numër të mjaftueshëm të autobusëve, komforë dhe me klimë;
- Dëshmi mjekësore për shëndetin e ngasësve të autobusëve;
- Përkujdesje të vazhdueshme mjekësore për nxënësit (mjeku i diplomuar dhe me certifikatë pune);

- Të ofrojnë mundësi verifikimi paraprak - të drejtëpërdrejtë të kushteve transportuese dhe hoteliere;
- Si dhe kushte të tjera sipas ligjit, që do të saktësohen edhe në kontratë.

**Afati i ofertimit:** 16.9.2019 - 23.9.2019.

**Materialet tenderuese dorëzohen në objektin e Komunës:** çdo ditë pune, në emër të SH.M.P. “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, në Zyrën e Pranimet.

**Hapja dhe vlerësimi i ofertave:** më 23.9.2019, ora 13:00, në objektin e Komunës (në Sallën e Kuvendit).

**Kërkesa u publikua:** në Tabelën e shpalljeve në SH.M.P. “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, dhe në Uebfaqen e Komunës së Kaçanikut ([kk.rks-gov.net/kacanik/](http://kk.rks-gov.net/kacanik/)).

Drejtori,  
z. Zekirja Baftiu

